



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION HIDROTEKNIK

Objekti: Rikonstruksion i Bllokut perpara pallatit te Kultures


Punimet e rikonstruksionit te Bllokut te lagjjes Naftetari perfsihjne edhe nderhyrje ne ndertimin e rrjetit te ri te kanalizimeve te ujrave te bardha dhe atyre te zeza ne segmentet dhe zona ku ky rrjet mungon.

Pas verifikimeve ne terren dhe konsultimeve me specialiste te agjensise se sherbimeve publike, u konstatua mungesa e kanalizimeve te ujrave te bardha dhe te zeza ne rruget “Thimi Sinjari” dhe “Ahmet Bajo”. Ne keto kushte, ne projekt-preventivin e hartuar te objektit u perfsihne nderhyrjet e meposhtme:




Pergjate rruges “Thimi Sinjari” eshte parashikuar ndertimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza duke perdorur puseta kontrolli me dimensione 1x1x1.5 m dhe puseta 1.5x1.5x1.5. Linja fillon me tuba te brinjezuar HDPE d=315mm per nje gjatesi prej 24 ml, vazhdon me pas me tub te brinjezuar HDPE d=400mm, ne nje gjatesi prej 168 ml ku behet lidhja e rrjetit te ri me puseten ekzistuese te kuz ne rrugen “Koli Marku”, vazhdon serish me te njejtin dimesion tubacioni deri ne puseten ekzistuese ne rrugen Demokracia dhe me pas linja vazhdon me tub te brinjezuar HDPE d=500mm deri sa shkarkon ne rrjetin e ujrave te zeza ne rrugen “Unaza”.

Pergjate rruges “Thimi Sinjari” nga piketa 1 deri ne piketen 14 eshte parashikuar gjithashtu ndertimi i kanalizimeve te ujrave te bardha te reshjeve. Ne kahun e poshtem te rruges, ku karrexhata me gjeresi 4 m plotesohet me kunete b/a me gjeresi 0.4m, do te ndertohen puseta shiu me dimensione 40x60, h=100cm, ujrat e se cilave do te shkarkojne ne pusetat e kuz nepermjet tubave te brinjezuar d=200mm.




Ne rrugen “Ahmet Bajo” plani i kanalizimeve fillon me ndertimin e dy pusetave te kontrollit me dimensione 0.8x0.8x1.5 m te cilat lidhen me tub te brinjezuar HDPE 315mm dhe shkarkojne ne puseten qe do te ndertohet ne kryqezimin me rrugen Thimi Sinjari. Ne kete segment kemi dhe ndertimin e dy shimblethesave ne kahun e majte te rruges midis piketes 2 dhe 4, ujrat e se cileve shkarkojne me tub te brinjezuar HDPE d=200 ne pusetat e kuz qe do te ndertohen. Ne segmentin e rruges “Ahmet Bajo” qe ndodhet midis kryqezimeve me rruget “Thimi Sinjari” dhe “Koli Marku” do te ndertohen 3 puseta kontrolli 1x1x1.5 ne nje largesi 18m nga njera-tjetra, te cilat do te lidhen me tub te brinjezuar HDPE d=315mm dhe do te shkarkojne ujrat ne puseten ekzistuese qe ndodhet ne rrugen Koli Marku.

PUSETE E UJRAVE TE ZEZA 100x100 cm, H=150 CM



PRERJE TERTHORE TIP Ø200 /315/400 DERI NE H=1.4M



Nepermjet nderhyrjeve te mesiperme mendohet te zgjidhet ne menyre te plote problematika e ujrave te zeza aktualisht te padisiplinuara ne Bllokun “Naftetari”.

*Hartoi: Ing. Gazmira Plesati
Ing. Silvana Mici*